

PËRMBLEDHJE PËR PROJEKTIN

Emri i projektit	Ballafaqimi me ndotjen e ajrit
E mbështetur nga	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP)
Programi	Projekti është pjesë e Kornizës Programore për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), i financuar nga Suedia
Roli i SHGM	Bashkëpunëtor i projektit
Buxheti total	4,212,585 denarë
Granti nga donatori:	4,212,585 denarë
Periudha e realizimit	Korrik 2023 – Dhjetor 2025
Territori	Maqedonia e Veriut
Për projektin	Përmbledhje
Konteksti	Projekti Ballafaqimi me ndotjen e ajrit ka për qëllim të mbështesë autoritetet lokale në pesë pilot komuna në Maqedoninë e Veriut, në drejtim të zbulimit dhe matjes së burimeve të ndotjes së ajrit, identifikimit, zhvillimit dhe zbatimit të masave të duhura për zgjidhjen e problemeve, forcimit të kapaciteteve të organizatave partneresi dhe ndërgjegjësimit të opinionit. Përfshirja dhe informimi i publikut për cilësinë e ajrit dhe çështjet e ndotjes është një faktor kyç për suksesin e projektit. Projekti i kushton vëmendje të veçantë ndërtimit të partneriteteve dhe rritjes së kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile (OSHC) dhe mediave, veçanërisht pasi ato kanë një rol kyç në prezantimin e saktë të fakteve, ndarjen e praktikave të mira dhe të këqija, rritjen e ndërgjegjësimit dhe kontribuojnë në rritjen e njohurive në gjetjen e zgjidhjeve për tu përballuar me ndotjen e ajrit. Bashkëpunimi me median do të sigurojë që të mbahet vëmendja e publikut tek çështjet që lidhen me ndotjen e ajrit në nivel kombëtar dhe lokal, si dhe do të ndikojë me presion ndaj vendimmarrësve për të vepruar dhe për të treguar rezultate në të dy nivelet. Një hallkë kyçe në këtë proces është investimi dhe motivimi i gazetarëve të rinj në të gjithë vendin për t'u njohur më mirë me temën dhe për të nxitur interesin e gazetarëve për monitorimin dhe raportimin e problemeve të ndotjes së ajrit, gjë që do të sigurojë qëndrueshmërinë e nismës edhe pas përfundimit zyrtar të projektit.. Në këtë drejtim, roli i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), si organizata më e vjetër dhe më e madhe në vend, në bashkëpunim me UNDP-në, është të kontribuojë në ngritjen e kapaciteteve të gazetarëve vendorë për monitorim dhe raportim për tema dhe çështje të ndërlidhura. ndaj ndotjes së ajrit dhe promovimit publik të përmbajtjes cilësore mediatike.
Qëllimi	Kontribut për përforcimin e kapaciteteve të gazetarëve lokal për monitorimin e dhe raportimin mbi temat dhe çështjet që lidhen me ndotjen e ajrit, dhe promovimin publik të produkteve kualitative gazetareske.
Grupe caku	Gazetarë (të paktën 55 pjesëmarrës në tre trajnime dy ditore dhe të fitues të çmimeve vjetore)
Rezultate të pritshme	- Më shumë shtytje për raportin të detajuar dhe të drejtë lidhur me çështjet e ndotjes së ajrit, - Nxitje e debatit më të gjerë për kualitetin e ajrit në bashkësitë lokale, nëpërmjet mjeteve dhe më shumë njohurive për krijimin e produkteve tërheqëse gazetareske që e informojnë opinionin në mënyrë efektive.
Aktivitete bartëse	Aktivitetet kyçe të projektit janë:

	• Organizim i tre çmimeve vjetore gazetareske • Përpunim i programit për ndërtimin e kapaciteteve • Organizimi i tre punëtorive dy ditore për 45 gazetarë nga mediat lokale • Përpilimi dhe publikimi i 18 produkteve tematike gazetareske
Logo (e donatorit)	